

Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike
Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Shëtitorja "Murat Toptani", 1001
Tiranë, Shqipëri



Thirrje për pjesëmarrje në
Konferencën shkencore ndërkombëtare
ENCIKLOPEDIZMI DHE BOTA SHQIPTARE

29-30 Qershor 2026

Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Tiranë

OBJEKTI

Konferenca shkencore ndërkombëtare “Enciklopedizmi dhe bota shqiptare” ka si objektiv themelor të vlerësojë historinë, tipologjitë dhe institucionet e enciklopedizmit në botën shqiptare, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, enciklopedi të përgjithshme, krahinore, tematike; leksikonë; antologji; botime referenciale etj. Po ashtu, synon të paraqesë dhe të diskutojë rezultatet e fazës së parë të hartimit të Enciklopedisë Shqiptare, si procesi i njësimit të fjalësit, verifikimi i përpjesëtimeve themelore të njësive dhe parametrat e përfaqësimit e po ashtu, të identifikojë problematika dhe të propozojë zgjidhje për standardizimin e stilit enciklopedik në gjuhën shqipe, në dialog me traditën e standardizimit gjuhësor, duke mbajtur parasysh faktin se Kongresi i Drejtshkrimit nuk u shpreh lidhur me këtë formë ligjërimi.

Në përfundim, do të paraqiten rezultatet e konferencës dhe do të mbahet një punëtori mbi shkrimin e një artikulli enciklopedik.

BOSHTET TEMATIKE DHE NËNTEMA TË SUGJERUARA

Tradita e enciklopedizmit dhe historia e botimeve referenciale në botën shqiptare: histori e enciklopedive/leksikonëve; bibliografi dhe kartografi botimesh; enciklopeditë krahinore dhe tematike; antologjitë e studimeve dhe studiuesve mbi një disiplinë; historikë dhe bibliografi institucionesh, qendra botimi dhe rrjete profesionale; roli i bibliotekave, arkivave dhe koleksioneve private.

Metodologjia e përzgjedhjes për një fjalës enciklopedik: kriteret për përfshirje/përfshirje; hierarkizimi i njësive; menaxhimi i dublimeve; terminologjia dhe kontrolli i leksikonit; standardizimi i emërtimeve; indeksimet dhe fjalët kyçe.

Stili enciklopedik i ligjëritit dhe normat e shkrimit: tipare të shkrimit enciklopedik (neutralitet, përmbledhje, verifikueshmëri përmes burimeve etj.); standarde redaktoriale dhe udhëzues praktikë e stilistikë; sfida të shqipes standarde në regjistrin enciklopedik; terminologji shkencore dhe qartësi për publikun jospesialist; raporti mes normës gjuhësore dhe traditës së enciklopedizmit.

Enciklopedizmi, teknologjia dhe botimet digjitale: enciklopedi digjitale, bazë të dhënash dhe menaxhim metadatash; interoperabilitet; ontologji dhe taksonomi; digitalizim koleksionesh; qëndrueshmëri e arkivimit; citueshmëri dhe identifikues digjitalë; sfida etike dhe cilësore në botimet online.

Qasja editoriale dhe institucionale ndaj enciklopedisë: shmangia e konfliktit të interesit dhe transparenca; etika në botim dhe integriteti akademik; menaxhimi i autorësisë; standarde për rishikimin dhe rivlerësimin shkencor .

FTOHEN TË MARRIN PJESË:

Studiues, pedagogë, doktorantë dhe kërkues të institucioneve akademike, arsimore dhe kërkimore; specialistë të botimeve dhe të trashëgimisë kulturore; studiues në fushat e gjuhësisë, albanologjisë,

historisë, letërsisë, antropologjisë, studime kulturore, shkenca të informacionit, bibliotekonomi, arkivistikë, muzeologji, studime të medias, edukim si dhe redaktorë shkencorë dhe përkthyesve.

GJUHËT E KONFERENCËS

Punimet e Konferencës do të kryhen në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe italisht.

UDHËZIME PËR DORËZIMIN

Abstrakti duhet të dorëzohet në një nga tri gjuhët e konferencës dhe duhet të përmbajë:

- **Titullin e kumtesës**, i shkruar me shkrim TNR, 12 ptt., **blod** dhe me shkronja kapitale, lart, në qendër;
- **Emrin dhe mbiemrin e autorit/autorëve** shkruar me shkrim TNR, 12 ptt., poshtë titullit, në të majtë;
- **Institucionin ku punon autori/autorët**, bashkë me njësinë dhe sektorin/departamentin përkatës, shkruar me shkrim TNR, 12 ptt, poshtë emrit të autorit, në të majtë;
- **Kontaktin**, e-mail dhe numër telefoni, shkruar me shkrim TNR, 12 ptt, poshtë institucionit, në të majtë;
- **Abstraktin**, jo më shumë se 250 karaktere bashkë me hapësira, shkruar me shkrim TNR, 11 ptt, i shpërndarë ndërmjet marginave me format *justify*;
- **Fjalë kyçe**, 3-5, shkruar poshtë abstraktit, me shkrim TNR, 10 ptt, *course*, të ndara nga njëra-tjetra me pikëpresje dhe me tab.

AFATE

Dorëzimi i abstrakteve: Deri më 22 maj, 2026.

Njoftimi për pranimin e abstrakteve: Brenda datës 15 qershor 2026.

Shpërndarja e programit: 22 qershor.

Organizimi i konferencës: Datë 29-30 qershor .

Vendi: Salla “Aleks Buda”, Akademia e Shkencave, Tiranë.

- Abstraktet duhet të dërgohen pranë koordinatores së Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, znj. Drisela Diamanti, në e-mailin driselad@gmail.com.

BORDI ORGANIZATIV

- Akad. Anila Hoda
- Andreas Dushi
- Majlinda Toçi
- Drisela Diamanti

BORDI SHKENCOR

- Akad. Matteo Mandalà
- Akad. Dhimitër Haxhimihali
- Prof. dr. Mimoza Priku
- Akad. Ilirian Malollari
- Akad. Shaban Sinani
- Prof. as. dr. Aristotel Spiro
- Dr. Luan Topçiu
- Dr. Belfjore Qose
- Dr. Jorina Verli